

## MARRËVESHJE

MARRËVESHJA PËRFUNDIMTARE PËR ZGJIDHJEN E DALLIMEVE TË PËRSHKRUARA NË REZOLUTAT 817 (1993) DHE 845 (1993) TË KËSHILLIT TË SIGURI MIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR SHFUQIZIMIN E MARRËVESHJES SË PËRKOSSHME TË VITIT 1995, DHE PËR VENDOSJEN E PARTNERITETIT STRATEGJIK NDËRMJET PALËVE

## PREAMBULA

Pala e parë, Greqia ("Pala e parë") dhe Pala e dytë, e cila ishte pranuar në Kombet e Bashkuara në pajtim me rezolutën 47/225 të 8 prillit 1993 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara ("Pala e dytë"), të emëruara së bashku si "Palët",

Duke u thirrur në parimet dhe qëllimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, Dokumentit përfundimtar të Helsinkit i vitit 1975, akteve relevante të Organizatës për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe vlerat dhe parimet e Këshillit të Evropës,

Të udhëhequra nga fryma dhe parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe dinjitetit,

Duke iu përmbajtur dispozitave të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe veçanërisht atyre të cilat kanë të bëjnë me obligimin e shteteve në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare të përmbahen nga kërcënimi apo përdorimi i forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të cilitdo shtet,

Duke e theksuar angazhimin e tyre të plotë për parimet për mos-cenimin e kufijve dhe integritetit territorial të shteteve, të përfshirë në Dokumentin Përfundimtar të Helsinkit të vitit 1975,

Duke e vërtetuar kufirin ekzistues ndërmjet tyre si kufi ndërkombëtar i përhershëm,

Të pajtuar plotësisht për nevojën e përforsimit të paqes, stabilitetit, sigurisë dhe avancimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit në Evropën Juglindore,

Me dëshirë që ta përforcojnë atmosferën e besimit dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore në Rajon dhe t'i ndërpresin në mënyrë të përhershme të gjitha qëndrimet armiqësore, të cilat do të mund të qëndrojnë ende dhe duke u pajtuar për nevojën e përmbajtjes nga irredentizmi dhe revizionizmi në cilëndo formë,

Duke u thirrur në obligimin e tyre, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe të drejtën ndërkombëtare, nën çfarëdo preteksti dhe në çfarëdo forme, të mos përzihen në punët e brendshme dhe kompetencat e Palës tjetër,

Duke e nënvizuar, gjithashtu, vlerën e zhvillimit të marrëdhënieve miqësore ndërmjet shteteve dhe nevojën kontestet të zgjidhen në mënyrë të qetë, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara,

Duke i zgjidhur dallimet në pajtim me Rezolutën 817 (1993) të 7 prillit 1993 dhe Rezolutën 845 (1993) të 18 qershorit 1993, të Këshillit të Sigurimit, si dhe nenin 5 të Marrëveshjes së Përkohshme të 13 shtatorit 1995 në mënyrë dinjitoze dhe të qëndrueshme, duke i pasur parasysh vlerën e çështjes dhe ndjeshmërisë së secilës Palë,

Duke e marrë parasysh Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 47/225 të 8 prillit 1993,

Duke e pasur parasysh Marrëveshjen e përkohshme, Memorandumin e 13 tetorit 1995 për masat praktike të lidhura me Marrëveshjen e përkohshme, Memorandumin për vendosje të ndërsjellë të zyrave për lidhje në Shkup dhe Athinë të 20 tetorit 1995, si dhe procesin e Masave për ndërtimin e besimit,

Duke e nënvizuar dëshirën e tyre të fuqishme për miqësi të ndërsjellë, fqinjësi të mirë dhe partneritet për bashkëpunim,

Me angazhim t'i përforcojnë, zgjerojnë dhe thellojnë marrëdhëniet e tyre bilaterale dhe të vendosin themele të forta për përforcimin dhe respektimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe për zhvillimin e bashkëpunimit të tyre bilateral,

Duke kërkuar që ta përforcojnë dhe zgjerojnë bashkëpunimin e vet bilateral dhe ta mbindërtojnë në nivel të partneritetit strategjik, në sferat e bujqësisë, mbrojtjes civile, mbrojtjes, ekonomisë, energjisë, mjedisit jetësor, industrisë, infrastrukturës, investimeve, marrëdhënieve politike, turizmit, tregtisë, bashkëpunimit tejk ufitarë dhe transportit, duke i shfrytëzuar pastaj përfitimet nga Masat ekzistuese për ndërtimin e besimit,

U dakorduan si vijon:

## PJESA 1

### ZGJIDHJA E DALLIMIT RRETH EMRIT, ÇËSHTJEVE TË PAPËRFUNDUARA LIDHUR ME TË NJËJTIN DHE PËRFORCIMI I MARRËDHËNIEVE TË FQINJËSISË SË MIRË

#### Neni 1

1. Kjo Marrëveshje është përfundimtare dhe me hyrjen e saj në fuqi shfuqizohet Marrëveshja e përkohshme mes palëve, e nënshkruar në Nju Jork, më 13 shtator 1995.

2. Palët e pranuan si obligues rezultatin nga negociatat, të cilat u zhvilluan nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara, e të cilat Palët ishin të obliguara t'i udhëheqin në pajtim me Rezolutën 817 (1993) dhe

Rezolutën 945 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe në pajtim me Marrëveshjen e përkohshme të vitit 1995.

3. Në pajtim me këto negociata, në mënyrë të ndërsjellë janë pranuar dhe dakorduar këto, si vijojnë:

a) Emri zyrtar i Palës së dytë do të jetë “Republika e Maqedonisë së Veriut”, i cili do të jetë emër Kushtetues i Palës së dytë dhe do të përdoret erga omnes, siç është paraparë me këtë marrëveshje. Emri i shkurtër i Palës së dytë do të jetë “Maqedonia e Veriut”.

b) Shtetësia e Palës së dytë do të jetë maqedonase/ qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut, siç do të shënohet në të gjitha dokumentet e udhëtimit.

c) Gjuha zyrtare e Palës së dytë do të jetë “gjuha maqedonase”, siç është pranuar në Konferencën e tretë të KB-së për standardizimin e emrave gjeografike, e mbajtur në Athinë në vitin 1977 dhe siç është e përshkruar në nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i kësaj marrëveshje.

ç) Termet “Maqedonia” dhe “maqedonase” e kanë domethënien e dhënë në nenin 7 të kësaj marrëveshje.

d) Kodi i vendit në targat e regjistrimit të automjeteve të Palës së dytë do të jetë NM ose NMK. Për të gjitha qëllimet tjera, kodi i vendit mbetet MK dhe MKD, siç është e përcaktuar zyrtarisht nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO).

dh) Mbiemri lidhur me shtetin, organet e tij zyrtare dhe institucionet tjera publike do të jenë në pajtim me emrin zyrtar të Palës së dytë ose me emrin e tij të shkurtër, përkatësisht “të Republikës së Maqedonisë së Veriut” ose “të Maqedonisë së Veriut”. Përdorime të tjera të mbiemrit, duke përfshirë edhe ato lidhur me entitetet dhe aktorët privatë, të cilët janë të lidhur me shtetin dhe entitetet publike, që nuk janë të themeluara me ligj dhe nuk marrin mbështetje financiare nga shteti për aktivitete jashtë shtetit, mund të jenë në pajtim me nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4). Përdorimi i mbiemrit për aktivitete mund të jetë në pajtim me nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4). Kjo nuk ndikon në procesin e përcaktuar sipas nenit 1, paragrafi 3 (ë) dhe në emrat e përbërë të qyteteve që ekzistojnë në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

e) Pala e dytë do ta pranojë emrin “Republika e Maqedonisë së Veriut” si emër të saj zyrtar, si dhe termet e cekura në nenin 1, paragrafi (3), duke e zbatuar procedurën e brendshme e cila është e

obligueshme dhe parevokueshme, që do të përfshijë miratimin e amendamentit të Kushtetutës, siç është përcaktuar me këtë marrëveshje.

ë) Lidhur me emrin e lartpërmendur dhe terminologjitë në emrat komercialë, markat tregtare dhe emrat e markave, Palët pajtohen që t'i mbështesin dhe inkurajojnë komunitetet e tyre afariste që të vendosin dialog të sigurtë, të strukturuar dhe të mirë, në kuadër të të cilit do të kërkojnë dhe do të arrijnë zgjidhje të përbashkëta për çështje të cilat dalin nga emrat komerciale, marka tregtare dhe emrat e markave dhe për të gjitha çështjet relevante, në nivel bilateral dhe ndërkombëtar. Për zbatimin e dispozitave të lartpërmendura, do të formohet grup ndërkombëtar i ekspertëve, të cilin do ta përbëjnë përfaqësues të dy vendeve, në kontekst të Bashkimit Evropian (BE) me kontributin përkatës të Kombeve të Bashkuara dhe ISO. Ky grup i ekspertëve do të formohet në vitin 2019, dhe do ta përfundojë punën e vet brenda tri vitesh. Asnjë dispozitë e nenit 1, paragrafi 3 (ë) nuk do të ndikojë mbi përdorimin e tanishëm komercial derisa nuk arrihet pajtim i ndërsjellë, siç është paraparë në këtë aline.

4. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Palët do t'i marrin hapat në vijim:

a) Pala e dytë, pa prolongim, do t'ia paraqesë Marrëveshjen Kuvendit për ratifikim.

b) Pas ratifikimit të Marrëveshjes në Kuvendin e Palës së dytë, Pala e dytë do ta njoftojë Palën e parë se Kuvendi i Palës së Dytë e ka ratifikuar Marrëveshjen.

c) Pala e dytë, nëse vendos ashtu, do të mbajë referendum.

ç) Pala e dytë do të nisë procesin për miratimin e amendamenteve kushtetuese, siç është paraparë në këtë marrëveshje,

d) Pala e dytë në tërësi do t'i miratojë amendamentet kushtetuese deri në fund të vitit 2018.

dh) Pas njoftimit të Palës së dytë për përfundimin e procedurës për miratimin e amendamenteve të lartpërmendura të Kushtetutës dhe për përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme juridike për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Pala e parë menjëherë do ta ratifikojë këtë marrëveshje.

5. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Palët do ta përdorin emrin dhe terminologjitë e përmendura në nenin 1, paragrafi 3 në të gjitha organizatat relevante ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale,

institucionet dhe forumet, përfshirë edhe të gjitha mbledhjet dhe korrespondencën dhe në të gjitha marrëdhëniet bilaterale me të gjitha shtetet – anëtare të Kombeve të Bashkuara.

6. Konkretisht, menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Pala e dytë do t'i:

a) Njoftojë të gjitha organizatat ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale, institucionet dhe forumet, anëtare e të cilave është, për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe pastaj do të kërkojë nga të gjitha ato organizata, institucione dhe forume ta pranojnë dhe përdorin emrin dhe terminologjitë e përmendura në nenin 1, paragrafi 3 të kësaj marrëveshjeje për të gjitha përdorimet dhe qëllimet. Të dyja Palët, gjithashtu, do t'i drejtohen Palës së dytë në pajtim me nenin 1, paragrafi 3 në të gjitha komunikimet ndaj, me dhe në kuadër të organizatave, institucioneve dhe forumeve të tilla.

b) Njoftojë të gjitha shtetet – anëtare të Kombeve të Bashkuara për hyrjen e kësaj marrëveshjeje në fuqi dhe do të kërkojë nga të njëjtat ta pranojnë dhe ta shfrytëzojnë emrin dhe terminologjitë e përmendura në nenin 1, paragrafi 3 nga kjo marrëveshje për të gjitha përdorimet dhe qëllimet, duke përfshirë edhe në të gjitha marrëdhëniet e saja bilaterale dhe komunikim.

7. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe në pajtim me dispozitat e nenit 1, paragrafi (9) dhe paragrafi (10) termet “Maqedoni”, “Republika e Maqedonisë”, “IRJ e Maqedonisë”, “IRJ. e Maqedonisë”, në formë të përkthyer ose të pa-përkthyer, si dhe emri i përkohshëm “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” dhe akronimi “IRJM” nuk do të përdoren ndaj Palës së dytë në cilindo kontekst zyrtar.

8. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, e duke marrë parasysh nenin 1, paragrafin (9) dhe paragrafin (10), Palët do ta shfrytëzojnë emrin dhe terminologjitë nga neni 1, paragrafi 3 për të gjitha përdorimet dhe qëllimet erga omnes, përkatësisht për përdorimin e brendshëm, dhe në të gjitha marrëdhëniet e veta bilaterale dhe në të gjitha Organizimet dhe institucionet rajonale dhe ndërkombëtare .

9. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Pala e dytë menjëherë dhe në pajtim me praktikën e shëndosha administrative do t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që organet kompetente të vendit që tani e tutje në mënyrë të brendshme ta përdorin emrin dhe terminologjitë nga neni 1, paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje në të gjitha dokumentet e reja zyrtare, në korrespondencë dhe në materiale relevante.

10. Në lidhje me rëndësinë e dokumenteve dhe materialeve tashmë ekzistuese të lëshuara nga autoritetet e Palës së dytë, Palët dakordohen të ketë dy periudha kalimtare, një “teknike” dhe një “politike”:

a) Periudha kalimtare “teknike” do t’u referohet të gjitha dokumenteve dhe materialeve zyrtare të administratës publike të Palës së dytë për përdorimin ndërkombëtar dhe dokumenteve për përdorimin e brendshëm, por të cilat mund të përdoren edhe jashtë shtetit. Këto dokumente dhe materiale do të përtëriten në pajtim me emrin dhe terminologjitë e theksuara në nenin 1, paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje, më së voni në afat prej pesë vitesh pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

b) Periudha kalimtare “politike” do t’u referohet të gjitha dokumenteve dhe materialeve, të cilat janë veçanërisht për përdorim të brendshëm në Palën e dytë. Lëshimi i dokumenteve dhe materialeve të tilla që janë në këtë kategori në pajtim me nenin 1, paragrafi 3 do të fillojë gjatë hapjes së secilit kapitull në fushën relevante në negociatat në Bashkimin Evropian dhe do të përfundojë në afat prej pesë vitesh nga atëherë.

11. Procedurat për miratimin e shpejtë të amendamenteve kushtetuese të Palës së Dytë, e me qëllim të zbatimit të plotë të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, do të fillojnë pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje nga Kuvendi i saj ose pas referendumit, nëse Pala e dytë vendos të mbajë referendum.

12. Emri dhe terminologjitë e përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje do të përfshihen në Kushtetutën e Palës së dytë. Ky ndryshim do të bëhet menjëherë me një amendament. Sipas këtij amendamenti, emri dhe terminologjitë do të ndryshohen në të gjitha nenet e Kushtetutës. Më tej, Pala e dytë do ta nisë procedurën për miratimin e amendamenteve përkatëse të Preambulës, neni 3 dhe neni 49 të Kushtetutës, gjatë procedurës për ndryshimin e Kushtetutës.

13. Në rast të gabimeve dhe lëshimeve në përdorimin e drejtë të emrit dhe terminologjive të përmendura në nenin 1 paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje në kontekst të organizatave ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale, institucioneve, korrespondencës, mbledhjeve dhe forumeve, si dhe në marrëdhëniet e përgjithshme bilaterale të Palës së dytë me shtete dhe entitete të treta, cilado nga Palët mund të kërkojë menjëherë të bëhet korrigjimi dhe të mënjanoen gabimet e ngjashme në të ardhmen.

## NENI 2

1. Pala e parë pajtohet që të mos i kundërshtojë kërkesat për anëtarësim ose anëtarësimin e Palës së dytë, me emrin dhe terminologjitë nga neni 1, paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale në të cilat Pala e parë është anëtare.

2. Pala e dytë do të kërkojë pranimin në organizata dhe institucione ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale me emrin dhe terminologjitë nga neni 1, paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje.

3. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, e në pajtim me nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, Pala e parë do të ratifikojë çfarëdo marrëveshjeje për aderimin e Palës së dytë në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Pala e parë është anëtare.

4. Në veçanti, sa i përket procesit të integritit të Palës së dytë në Bashkimin Evropian (BE) dhe Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), do të aplikohen:

a. Pala e dytë do të kërkojë anëtarësim në NATO dhe BE me emrin dhe terminologjitë nga neni 1 i kësaj marrëveshjeje. Anëtarësimi në NATO dhe BE do të bëhet me të njëjtin emër dhe terminologji.

b. Pas marrjes së njoftimit se Kuvendi i Palës së dytë e ka ratifikuar këtë marrëveshje, Pala e parë menjëherë:

(i) do ta njoftojë kryetarin e Këshillit të Bashkimit Evropian se e mbështet fillimin e negociatave për anëtarësimin e Palës së dytë në Bashkimin Evropian, me emrin dhe terminologjitë nga neni 1 i kësaj marrëveshjeje.

(ii) do ta njoftojë sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s se e mbështet ftesën për anëtarësimin e Palës së dytë. Mbështetja e tillë e Palës së parë kushtëzohet, së pari, me rezultatin e referendumit, nëse Pala e dytë vendos të mbajë referendum në pajtim me këtë marrëveshje dhe së dyti, me miratimin e plotë të amendamenteve kushtetuese, siç është e paraparë në këtë marrëveshje. Pas marrjes së njoftimit nga Pala e dytë se i ka përfunduar të gjitha procedurat e saj të brendshme juridike të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë edhe referendum të mundshëm nacional me një rezultat në përputhje me këtë marrëveshje dhe pas përfundimit të procedurës për miratimin e amendamenteve kushtetuese të Palës së dytë, Pala e parë do ta ratifikojë Protokollin për anëtarësimin e Palës së dytë në NATO. Kjo procedurë e ratifikimit do të përfundojë së bashku me procedurën e ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.

### NENI 3

1. Palët me këtë e vërtetojnë kufirin e tyre të ndërsjellë ekzistues si kufi ndërkombëtar i pacenueshëm dhe i përherëshëm. Asnjëra nga palët nuk do të mbrojë ose mbështesë kurrfarë pretendimesh ndaj

cilësdo pjesë të territorit të Palës tjetër, e as pretendime për ndryshim të kufirit të tyre të ndërsjellë ekzistues. Përveç kësaj, asnjëra nga Palët nuk do të mbështesë çfarëdo lloj pretendimesh të tilla të cilat mund t'i shprehin palët e treta.

2. Secila Palë obligohet ta respektojë sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të Palës tjetër. Asnjëra nga Palët nuk do të mbështesë çfarëdo lloj aktiviteti të palëve të treta drejtuar kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të Palës tjetër.

3. Të dyja Palët, në pajtim me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, do të përmbahen nga kërcënimet ose përdorimi i forcës, duke përfshirë edhe kërcënimet ose përdorimin e forcës me qëllim që të prishet kufiri i ndërsjellë ekzistues.

4. Të dyja Palët obligohen se nuk do të ndërmarrin, nxisin, mbështesin dhe/ose tolerojnë çfarëdo lloj veprimtarish ose aktivitetesh të karakterit armiqësor drejtuar Palës tjetër. Asnjëra nga Palët nuk do të lejojë që territori i vet të shfrytëzohet kundër Palës tjetër nga palët e treta, organizatat, grupet dhe individët të cilat kryejnë ose orvaten të kryejnë veprime subverzive, secesioniste, ose veprime ose aktivitete që paraqesin në çfarëdo lloj mënyre kërcënim të paqes, stabilitetit ose sigurisë së Palës tjetër. Secila Palë pa prolongim do t'i përcjellë Palës tjetër informata të cilat ajo i posedon në lidhje me aktivitetet ose qëllimet e tilla.

#### NENI 4

1. Secila nga Palët me këtë obligohet dhe deklaron në mënyrë solemne se asnjë dispozitë nga Kushtetuta e saj, siç është në fuqi ose siç do të ndryshohet në të ardhmen, nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet si mënyrë, e cila paraqet ose kur do qoftë do të paraqesë bazë për çfarëdo pretendimi ndaj të cilësdo sferë e cila nuk është në kuadër të kufijve të saj ndërkombëtare ekzistuese.

2. Secila nga Palët obligohet të mos japë, dhe as të lejojë çfarëdo lloj deklaratash irredentiste dhe se nuk do të miratojë çfarëdo lloj deklaratash të tilla të dhëna nga ata të cilët pohojnë se veprojnë në emër ose në interes të njëres prej Palëve.

3. Secila nga Palët me këtë obligohet dhe deklaron solemnisht se asnjë dispozitë nga Kushtetuta e saj, siç është në fuqi ose siç do të ndryshohet në të ardhmen, nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet në mënyrë e cila paraqet ose kurdo qoftë do të paraqesë bazë për përzierje në punët e brendshme të Palës tjetër, në cilëndo formë ose për cilëndo qoftë arsye, duke përfshirë dhe për shkak të mbrojtjes së statusit dhe të drejtave të cilave do persona të cilët nuk janë qytetarë të saj.



## NENI 5

1. Në kryerjen e punëve të saj, Palët do të udhëhiqen nga fryma dhe parimet e demokracisë, lirive themelore, respektimit të të drejtave njerëzore dhe dinjitetit dhe sundimit të së drejtës, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut<sup>1</sup>, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut<sup>2</sup>, Konventën Ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor<sup>3</sup>, Konventën për të drejtat e fëmijës<sup>4</sup>, Dokumentin përfundimtar të Helsinkit, Dokumentin nga mbledhja në Kopenhagë e Konferencës për dimensionin njerëzor të Konferencës për siguri dhe bashkëpunim në Evropë dhe Kartën e Parisit për Evropë të Re, dhe marrëveshjeve tjera ndërkombëtare dhe instrumente në të cilën kanë aderuar të dyja Palët.

2. Asnjë dispozitë nga cilido instrument i përmendur në paragrafin 1 nuk do të interpretohet se i jep të drejtë cilësdo qoftë nga Palët të ndërmarrin veprime në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara ose Dokumentit Përfundimtar të Helsinkit, duke përfshirë dhe në kundërshtim me parimin e integritetit territorial të shteteve.

## NENI 6

1. Me qëllim të forcimit të marrëdhënieve bilaterale shoqërore, secila nga Palët menjëherë do të ndërmarrë masa efektive për t'i penguar cilat do qoftë aktivitete, veprimtari armiqësore, ose propagandë nga ana e organeve shtetërore ose organet nën kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të shtetit dhe për të parandaluar veprimtari që mund të nxisin shovinizëm, armiqësi, irredentizëm dhe revizionizëm kundër Palës tjetër. Nëse paraqiten aktivitete të tilla, të dyja Palët do t'i marrin të gjitha masat e nevojshme.

2. Secila nga Palët menjëherë do të ndërmarrë masa efektive për të shkurajuar dhe parandaluar çdo veprim nga entitete private, që mund të nxisin dhunë, urrejtje ose armiqësi kundër Palës tjetër. Nëse entiteti privat i territorit të cilësdo qoftë nga Palët kryen veprime të tilla pa dijeninë e asaj Pale, ajo Palë, sapo të mësojë për veprime të tilla, menjëherë do t'i ndërmarrë masat e nevojshme të parapara me ligj.

3. Secila nga Palët do të parandalojë dhe shkurajojë veprime, duke përfshirë edhe veprimtari të propagandës nga ana e entiteteve private, veprime që mund të nxisin shovinizëm, armiqësi, irredentizëm dhe revizionizëm kundër Palës tjetër.

## NENI 7

1. Palët pranojnë se kuptimi i tyre përkatës i termeve “Maqedoni” dhe “maqedonas” i referohet kontekstit të ndryshëm historik dhe trashëgimisë kulturore.

2. Kur i referohemi Palës së parë, këto terme shënojnë jo vetëm sferën e popullit të rajonit të veriut të Palës së parë, por gjithashtu edhe karakteristikat e tyre, si dhe civilizimin helen, historinë, kulturën dhe trashëgiminë në atë rajon që nga antika e deri sot.

3. Kur i referohemi Palës së dytë, këto terme e shënojnë territorin e saj, gjuhën, popullin dhe karakteristikat e tyre me historinë e tyre, kulturën dhe trashëgiminë të cilat janë të ndryshme nga ato të përmendura në Nenin 7 paragrafi (2).

4. Pala e dytë deklaron se gjuha e saj zyrtare, gjuha maqedonase, bën pjesë në grupin e gjuhëve të sllavëve të jugut. Të dyja Palët deklarojnë se gjuha zyrtare dhe karakteristikat tjera të Palës së dytë nuk janë të lidhura me civilizimin helen, historinë, kulturën dhe trashëgiminë e rajonit të veriut të Palës së parë.

5. Asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk ka për qëllim të diskreditojë në çfarëdo lloj mënyre, ndryshojë ose ndikojë në përdorimin nga qytetarët e të dy Palëve.

## NENI 8

1. Në qoftë se cilado nga të dyja Palët beson se një ose më shumë simbole të cilat përbëjnë pjesë të trashëgimisë së saj historike ose kulturore i përdor Pala tjetër, ajo për gjoja përdorimin e tillë do t'i sugjeroj Palës tjetër ndërsa Pala tjetër do të ndërmarrë veprime korrigjuese përkatëse me qëllim që të merret me çështjen në mënyrë efektive dhe të sigurojë respektim të trashëgimisë së tillë.

2. Në afat prej gjashtë muajsh nga hyrja e kësaj marrëveshjeje në fuqi Pala e dytë do ta shqyrtojë statusin e përmendoreve, ndërtesave publike dhe infrastrukturës së territorit të saj dhe nëse ato në çfarëdo lloj mënyre referojnë në historinë dhe civilizimin helen antik që përbën pjesë përkatëse të trashëgimisë historike ose kulturore të Palës së parë do të ndërmarrë veprime korrigjuese përkatëse me qëllim që në mënyrë efektive ta shqyrtojë çështjen dhe të sigurojë respektimin e trashëgimisë së tillë.

3. Pala e dytë nuk do ta përdorë përsëri në çfarëdo lloj mënyre dhe në çfarëdo lloj forme simbolin e paraqitur në flamurin e saj shtetëror. Në afat prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj

marrëveshje, Pala e dytë do ta nisë procedurën për heqjen e simbolit të paraqitur në flamurin e saj të mëparshëm shtetëror nga të gjitha vendet publike dhe nga përdorimi publik në territorin e sajë. Artefaktet arkeologjike nuk janë të përfshira në këtë dispozitë.

4. Secila nga Palët do t'u përmbahet rekomandimeve të Konferencës së Kombeve të Bashkuara për standardizim të emrave gjeografike në lidhje me përdorimin e emrave gjeografike zyrtare dhe toponimeve të territorit të Palës tjetër, duke i dhënë prioritet me këtë rast shfrytëzimit të endonimeve në vend të ekzonimeve.

5. Në afat prej një muaji nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje Palët nëpërmjet këmbimit të notave diplomatike, në bazë të paritetit, do të formojnë Komitet të përbashkët interdisiplinar të ekspertëve për çështje historike, arkeologjike dhe arsimore, i cili do ta shqyrtojë interpretimin shkencor objektiv të ngjarjeve historike të bazuara në dëshmi autentike dhe në burime të qëndrueshme historike dhe shkencore dhe gjetjeve arkeologjike. Ministrinë e Punëve të Brendshme të të dyja Palëve do ta mbikëqyrin punën e Komitetit në bashkëpunim me autoritetet tjera shtetërore kompetente. Komiteti do të shqyrtojë edhe nëse mendon se është e përshtatshme, do të kryej revizion mbi cilindo libër shkollor dhe material mësimor ndihmës siç janë hartat, atlasat historike, udhëzimet mësimore të cilat shfrytëzohen nga të dyja Palët në pajtim me parimet dhe qëllimet e UNESCO-së dhe Këshillit të Evropës. Për këtë qëllim, Komiteti do të caktojë korniza kohore konkrete për të siguruar se në secilën Palë asnjë libër shkollor ose material mësimor ndihmës që shfrytëzohet në vitin pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nuk përmban çfarëdo lloj referencash revizioniste/irredentiste. Komiteti gjithashtu, do t'i studiojë edhe botimet e reja të librave shkollorë dhe materialeve mësimore ndihmëse, siç është paraparë në këtë nen. Komiteti do të mbajë mbledhje rregullisht, së paku dy herë në vit dhe do të parashtrijë raport vjetor për aktivitetet e veta si dhe rekomandimet që duhet të miratohen nga Këshilli për bashkëpunim i nivelit të lartë i cili do të formohet në pajtim me nenin 12.

6. Palët pranojnë se zgjidhjet e lartpërmendura të pranuar reciprokisht, që dalin nga negociatat, do të kontribuojnë për vendosje përfundimtare të marrëdhënieve paqësore dhe të fqinjësisë së mirë në Rajon, në pajtim me Rezolutën 817 (1993) dhe Rezolutën 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

PJESA 2

INTENSIFIKIMI DHE PASURIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRMJET DY PALËVE

NENI 9

1. Palët pajtohen se bashkëpunimi i tyre strategjik do të shtrihet në të gjithë sektorët, siç janë bujqësia, mbrojtja civile, mbrojtja, ekonomia, energjia, mjedisi jetësor, industria, infrastruktura, investimet, marrëdhëniet politike, turizmi, tregtia, bashkëpunimi tejkufitar dhe transporti. Bashkëpunimi i tillë strategjik do të realizohet jo vetëm në sektorët e përfshirë me këtë marrëveshje, por gjithashtu edhe në ato sektorë të cilët në të ardhmen do të konsiderohen të dobishëm dhe të domosdoshëm për të dyja vendet. Të gjithë këta sektorë duhet të inkorporohen në plan veprimin gjithëpërfshirës gjatë zhvillimit të marrëdhënieve bilaterale.

2. Masat ekzistuese për ndërtimin e besimit do të inkorporohen në plan veprimin e lartpërmendur. Plan veprimi ka për qëllim zbatimin e dispozitave të kësaj pjese nga kjo marrëveshje. Plan veprimi do të pasurohet dhe zhvillohet vazhdimisht.

## MARRËDHËNIET DIPLOMATIKE

### NENI 10

Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje:

1. Pala e parë menjëherë do ta ngrit nivelin:

a) e Zyrës së vet ekzistuese për lidhje në kryeqytetin e Palës së dytë në nivel të ambasadës; dhe

b) të Zyrës së vet ekzistuese për çështje konsullore, ekonomike dhe tregtare në qytetin Manastir, të Palës së dytë, në nivel të Konsullatës së përgjithshme; dhe

2. Pala e dytë menjëherë do ta ngrit nivelin:

a) e Zyrës së vet ekzistuese për lidhje në kryeqytetin e Palës së parë në nivel të ambasadës; dhe

b) të Zyrës së vet ekzistuese për punë konsullore, ekonomike dhe tregtare në qytetin Selanik, të Palës së parë, në nivel të konsullatës së përgjithshme.

## BASHKËPUNIMI NË KONTEKST TË ORGANIZATAVE DHE FORUMEVE NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE

### NENI 11

Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë të ngushtë, bilaterale dhe në kuadër të organizatave dhe iniciativave rajonale, me qëllim që të sigurojnë se Evropa Juglindore do të bëhet rajon i paqes, zhvillimit dhe prosperitetit për popujt e vet. Ato do të promovojnë dhe do bashkëpunojnë në definimin e bashkëpunimit në nivel rajonal, si dhe do të bashkëpunojnë edhe në mbështetjen e ndërsjellë të kandidaturave të tyre në kontekst të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale, siç janë Kombet e Bashkuara, OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës.

## BASHKËPUNIMI POLITIK DHE SHOQËROR

### NENI 12

1. Palët dakordohen që t'i forcojnë dhe zhvillojnë më tej marrëdhëniet e tyre bilaterale politike, përmes vizitave, takimeve dhe konsultimeve të rregullta në nivel të lartë politik dhe diplomatik.

2. Palët do të formojnë Këshill për Bashkëpunim të Nivelit të Lartë (KBNL), që do të përbëhet nga përfaqësues të qeverive të tyre, të kryesuar bashkërisht nga kryeministrat e tyre.

3. KBNL-ja do të caktojë mbledhje të paktën një herë në vit dhe do të jetë trup kompetent për zbatimin e duhur dhe efektiv të kësaj marrëveshjeje dhe plan veprimit që do të dalë nga ajo. KBNL-ja do të marrë vendime dhe do të promovojë aktivitete dhe masa për përmirësimin dhe përsosjen e bashkëpunimit bilateral ndërmjet dy Palëve dhe do të shqyrtojë çdo lloj çështje që mund të dalë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe plan veprimit që do të dalë nga ajo, me qëllim të zgjidhjes së çështjeve të tilla.

4. Palët janë të bindura se zhvillimi dhe forcimi i kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet njerëzve janë me rëndësi esenciale për zhvillimin e miqësisë, bashkëpunimit dhe fqinjësisë së mirë ndërmjet Palëve dhe popujve të tyre. Ata do t'i mbështesin dhe inkurajojnë kontaktet dhe takimet e tilla ndërmjet qytetarëve të tyre në të gjitha nivelet e duhura.

5. Palët do të japin mbështetje dhe do t'i nxisin kontaktet ndërmjet shoqërive të tyre civile, si dhe ndërmjet institucioneve të tyre dhe autoriteteve lokale, duke përfshirë dhe aktivitetet për

bashkëpunimin ndërmjet të rinjve dhe studentëve, si dhe shkëmbimin e tyre, me qëllim të arritjes së mirëkuptimit dhe bashkëpunimit më të mirë me popujt e tyre.

## BASHKËPUNIMI EKONOMIK

### NENI 13

Duke marrë parasysh faktin që Pala e Dytë është shtet pa dalje në det, Palët do të udhëhiqen nga dispozitat relevante të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën në Det, për aq sa është e zbatueshme në praktikë dhe gjatë lidhjes së marrëveshjeve të përmendura në nenin 18 të kësaj marrëveshjeje.

### NENI 14

1. Palët më tej do ta zhvillojnë bashkëpunimin e tyre ekonomik në të gjitha fushat. Theksi i veçantë do të vendoset në përforcimin dhe thellimin e bashkëpunimit bilateral në fushën e bujqësisë, energjisë, mjedisit jetësor, industrisë, infrastrukturës, investimeve, turizmit, tregtisë dhe transportit. Për arritjen e këtyre qëllimeve, Palët do t'i përdorin dhe shfrytëzojnë Masat ekzistuese për ndërtimin e besimit, të cilat paraqesin platformë reciproke të dobishme për bashkëpunim, e cila do të zhvillohet në plan veprim.

2. Palët do t'i inkurajojnë investimet reciproke dhe do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e tyre efektive, duke përfshirë dhe masat kundër burokracisë së tepërt dhe për tejkalimin e pengesave institucionale, administrative dhe tatimore. Palët veçanërisht do të fokusohen në bashkëpunimin ndërmjet kompanive, subjekteve afariste dhe industrive të secilës prej Palëve.

3. Palët do të përmbahen nga vendosja e çdo pengese për lëvizjen e personave dhe mallrave ndërmjet territoreve të tyre dhe nëpërmjet territorit të secilës Palë në territorin e Palës tjetër. Palët do të bashkëpunojnë për ta lehtësuar lëvizjen e tillë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

4. Palët do të zhvillojnë dhe nxisin bashkëpunimin e tyre në sektorin e energjisë, veçanërisht nëpërmjet ndërtimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të gazsjellësve dhe naftësjellësve interkonektivë (ato që janë në ndërtim e sipër dhe të projektuarat), ndërsa do të bashkëpunojnë në lidhje me burimet përtëritëse të energjisë, duke përfshirë kapacitetet diellore, të erës dhe hidrocentraleve. Çështjet e mundshme të pazgjidhura do të shqyrtohen shpejtë dhe do të arrihet zgjidhje e pranueshme reciproke, me ç'rast do të

merret parasysh Politika evropiane për energji dhe legjislacioni evropian në këtë fushë. Pala e parë do ta ndihmojë Palën e dytë nëpërmjet transferimit të duhur të njohurive dhe ekspertizës.

5. Palët do të promovojnë, zgjerojnë dhe përmirësojnë sinergjinë bashkëpunuese në fushat e infrastrukturës dhe transportit, si dhe në bazë reciproke edhe në fushat e transportit rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror dhe lidhjet e komunikimeve, duke përdorur teknologjitë dhe praktikat më të mira në dispozicion. Ato, gjithashtu, do të lehtësojnë transitin e mallrave dhe ngarkesave ndërmjet tyre, nëpërmjet infrastrukturës, duke përfshirë portet dhe aeroportet, në territoret e secilës Palë. Palët do t'u përmbahen rregullave dhe rregullativave ndërkombëtare në lidhje me transitin, telekomunikimet, shenjat dhe kodet. Pala e parë do ta bëjë këtë deri në atë masë dhe në mënyrë që do të jetë në përputhje me detyrimet e saj që do të dalin nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare. Pala e dytë do ta bëjë atë deri në atë masë dhe në mënyrë që do të jetë në përputhje me detyrimet e tyre që dalin nga anëtarësimi i saj në institucionet ndërkombëtare, multilaterale ose rajonale institucionet ose organizatat ku e njëjta është anëtare në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, si dhe detyrimet që do të dalin nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian, pasi që të propozohet anëtarësimi i saj në të.

6. Palët do të përpiqen t'i përmirësojnë dhe modernizojnë kalimet kufitare ekzistuese, siç kërkohet nga qarkullimi i komunikacionit, ndërsa gjithashtu do të ndërtojnë vendkalime të reja kufitare, me qëllim që të inkurajojnë shkëmbimet turistike dhe tregtare ndërmjet tyre.

7. Palët do të marrin masa për të siguruar mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe ruajtjen e mjedisit natyror në ujërat ndërkufitare dhe mjedisin e tyre dhe do të bashkëpunojnë në përpjekjet për zvogëlimin dhe eliminimin e të gjitha formave të ndotjes. Palët do të përpiqen të zhvillojnë dhe harmonizojnë strategjitë dhe programet për bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në mbrojtjen e mjedisit jetësor.

8. Palët do japin mbështetje për zgjerimin e shkëmbimit turistik dhe zhvillimin e bashkëpunimit të tyre në fushat e turizmit alternativ, duke përfshirë turizmin kulturor, fetar, arsimor, mjekësor dhe sportiv dhe do të bashkëpunojnë për përmirësimin dhe përparimin e udhëtimeve afariste dhe turistike ndërmjet tyre.

9. Palët do të formojnë Komitetin e Përbashkët të Ministrave (KPM) i cili do të ketë për qëllim arritjen e bashkëpunimit më të mirë të mundshëm në sektorët e lartpërmendur të partneritetit ekonomik, duke përfshirë dhe nëpërmjet organizimit të forumeve të përbashkëta afariste. Komiteti do të takohet të paktën një herë në vit dhe do të menaxhojë me vijimin e bashkëpunimit ekonomik bilateral, me zbatimin gjithëpërfshirës të veprimtarive përkatëse sektoriale, protokolleve dhe marrëveshjeve kornizë kontraktuese, si dhe çdo marrëveshjeje relevante në të ardhmen. Palët nxisin bashkëpunim sa më të afërt ndërmjet odave të tyre ekonomike.

## BASHKËPUNIMI NË SFERËN E ARSIMIT, SHKENCËS, KULTURËS, HULUMTIMIT, TEKNOLOGJISË, SHËNDETËSISË DHE SPORTIT

### NENI 15

Në epokën e re të revolucionit industrial dhe gjeneratën e dytë të makinave, thellimi i bashkëpunimit ndërmjet shteteve dhe shoqërive është i domosdoshëm më shumë se kurdoherë, veçanërisht në lidhje me aktivitetet shoqërore, teknologjike dhe kulturore në kuptimin më të ngushtë dhe më të gjerë. Me qëllim të avancimit të tij:

1. Palët do të zhvillojnë dhe përmirësojnë bashkëpunimin e tyre shkencor, teknologjik dhe teknik, si dhe bashkëpunimin e tyre në fushën e arsimit. Ato do të intensifikojnë shkëmbimin e informacionit dhe dokumentacionit shkencor dhe teknik dhe do të përpiqen të përmirësojnë qasjen në institucionet shkencore dhe hulumtuese, arkivat, bibliotekat dhe institucionet e ngjashme. Palët do t'i mbështesin iniciativat nga institucionet shkencore dhe arsimore, si dhe nga individët që kanë për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit në fushat e shkencës, teknologjisë dhe arsimit.

2. Palët do mbështesin dhe inkurajojnë evenimente, si dhe programe mësimore shkencore në të cilat marrin pjesë anëtarët e komunitetit shkencor dhe akademik pjesëtarët. Ato, gjithashtu, do të mbështesin dhe inkurajojnë organizimin e konferencave bilaterale dhe ndërkombëtare në këto fusha.

3. Palët i japin rëndësi të madhe zhvillimit të hulumtimit, si dhe zbatimit dhe shfrytëzimit të teknologjive të reja, duke përfshirë teknologjinë digjitale dhe nanoteknologjinë, në mënyrë me të cilën ruhet mjedisi jetësor dhe përsosën aftësitë, kapacitetet dhe gjendja e mirë e përgjithshme e qytetarëve të tyre. Andaj, Palët do të zhvillojnë bashkëpunimin ndërmjet qendrave të tyre hulumtuese, hulumtuesve dhe sistemeve të institucioneve akademike.

4. Palët do të vendosin theks të veçantë në zhvillimin e marrëdhënieve kulturore ndërmjet dy shteteve, shoqërive të tyre dhe grupeve sociale, duke marrë parasysh veçanërisht artin, vallen, kinematografinë, muzikën dhe teatrin. Në këtë aspekt rëndësi e veçantë i jepet marrëveshjes. Do të avancohet bashkëpunimi bilateral në sferën e shëndetësisë, duke përfshirë edhe mbrojtjen shëndetësore.

## BASHKËPUNIMI POLICOR NË SFERËN E MBROJTJES CIVILE



## NENI 16

1. Palët do të bashkëpunojnë ngushtë në luftën kundër krimit të organizuar dhe tejkuftar, terrorizmit, krimit ekonomik, veçanërisht kundër krimit lidhur me tregtinë jolegale dhe/ose eksploatimin e njerëzve, krimit lidhur me prodhimin, tregtinë e palejuar dhe/ose tregtinë jolegale të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, prodhimin jolegal dhe tregtimin me armë, pjesët rezerve dhe komponentët e tij, si dhe municionin, pastaj importin jolegal, eksportin dhe bartjen e pronësisë së pronës kulturore, si dhe kundër veprave kundër aviacionit civil dhe veprave të lidhura me falsifikimin dhe/ose kontrabandë me cigare, alkool ose karburante.

2. Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë të ngushtë në sferën e mbrojtjes civile, veçanërisht duke u fokusuar në parandalimin dhe ballafaqimin me katastrofa natyrore dhe katastrofa të shkaktuara nga njeriu dhe në aktivitete për ballafaqim me pasojat nga katastrofat. Secila Palë mund ta shfrytëzojë edukimin e specializuar dhe ekspertizën e Palës tjetër dhe çdoherë kur ajo është e nevojshme dhe e mundur secila Palë do t'i mundësojë Palës tjetër shfrytëzimin e infrastrukturës së vet speciale, veçanërisht për mbrojtje kundër zjarrit. Palët mund ta shqyrtojnë mundësinë për vendosjen e mekanizmit relevant për ndihmë në zbatimin e dispozitave të këtij neni.

## BASHKËPUNIMI NË SFERËN E MBROJTJES

## NENI 17

Palët do ta përforcojnë dhe zgjerojnë bashkëpunimin e tyre në sferën e mbrojtjes, duke i përfshirë edhe takimet e shpeshta dhe kontaktet ndërmjet liderëve politikë dhe ushtarakë të fuqive të tyre të armatosura, pastaj nëpërmjet transmetimit adekuat të njohurive dhe ndihmës për ndërtimin e kapaciteteve, bashkëpunimit në sferat e prodhimit, informimit dhe ushtrimeve të përbashkëta ushtarake. Palët posaçërisht do të fokusohen në trajnimin e personelit të cilin Palët ndërmjet veti mund ta sigurojnë.

## MARRËDHËNIET KONTRAKTUESE

## NENI 18

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, në marrëdhëniet e tyre, Palët do të udhëhiqen nga dispozitat e marrëveshjeve bilaterale të cilat ishin të lidhura ndërmjet ish -Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe Palës së Parë, më 18 qershor 1959:

a) Konventa për marrëdhënie të ndërsjella juridike,

b) Marrëveshja në lidhje me njohjen e ndërsjellë dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe

c) Marrëveshja për çështjet nga sfera e ekonomisë së ujërave.

2. Palët pajtohen se pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, të gjitha dokumentet ndërkombëtare të cilat janë obliguese për Palët do të mbeten në fuqi, përveç atyre shfuqizimi i të cilave është i paraparë konkretisht me këtë marrëveshje.

3. Palët ndërmjet veti do të konsultohen me qëllim të identifikimit të marrëveshjeve tjera të lidhura ndërmjet Ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe Palës së parë, për të cilat ato do të konsiderojnë se janë adekuate të zbatohen në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella.

4. Palët obligohen t'i hulumtojnë të gjitha mundësitë për lidhjen e marrëveshjeve plotësuese bilaterale, të nevojshme në sferat me interes të ndërsjellë.

### PJESA 3

### ZGJIDHJA E KONTESTEVE

### NENI 19

1. Palët të gjitha kontestet do t'i zgjidhin vetëm me mjete paqësore, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara.

2. Në rast se njëra Palë konsideron se Pala tjetër nuk vepron në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, ajo Palë për shqetësimin e vet do ta njoftojë Palën tjetër dhe do të kërkohet zgjidhje

nëpërmjet negociatave. Nëse Palët nuk mund ta zgjidhin çështjen në mënyrë bilaterale, Palët mund të pajtohen të kërkojnë nga sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara t'i përdorë shërbimet e mira të tij për zgjidhjen e çështjes.

3. Secili kontest që do të paraqitet ndërmjet palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe i cili nuk do të zgjidhet në pajtim me procedurat e theksuara në nenin 19, paragrafin (2), mund të ngrihet nëpërmjet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Palët së pari duhet të insistojnë të arrijnë pajtim me qëllim që së bashku të ngritin kontest të tillë para gjykatës së lartpërmendur. Megjithatë, nëse nuk arrihet pajtim i tillë në afat prej gjashtë muajsh, ose për periudhë më të gjatë për të cilën në mënyrë të ndërsjellë do të pajtohen të dyja Palët, atëherë kontestin e tillë para gjykatës së njëjtë mund ta ngrit secila Palë veç e veç.

## DISPOZITA TË FUNDIT

### NENI 20

1. Këtë marrëveshje do ta nënshkruajnë Ministrat e Punëve të Jashtme të të dyja Palëve.

2. Kjo Marrëveshje është lëndë e ratifikimit, në pajtim me procedurën vijuese të paraparë në nenin 1, paragrafi (4).

3. Pas përfundimit të procedurave të domosdoshme të brendshme juridike për hyrje në fuqi të kësaj marrëveshjeje, siç është paraparë në nenin 1, në afat prej dy javëve, Palët me shkrim do të informohen në mënyrë të ndërsjellë për të njëjtën. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi me datën e pranimit të njoftimit të fundit nga Pala tjetër.

4. Neni 8, paragrafi (5) do të aplikohet përkohësisht edhe para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Nëse kjo marrëveshje nuk hyn në fuqi, kjo marrëveshje, në tërësi dhe çdo dispozitë e saj veçmas nuk do të ketë asnjë efekt ose fuqi, as të përkohshëm, apo çfarëdo tjetër dhe ajo në asnjë mënyrë nuk do ta obligojë cilën do prej Palëve.

5. Dallimi dhe çështjet tjera të paraqitura në Rezolutën 817 (1993) dhe Rezolutën 845 (1993) të Këshillit të KB-së për siguri do të konsiderohen të zgjidhura pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

6. Sa më shpejtë që është e mundur, pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Palët ose njëra prej Palëve do ta informojë sekretarin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, si dhe për datën kur ajo ka hyrë në fuqi, e me qëllim të zbatimit të saj në Kombet e Bashkuara.

7. Kjo marrëveshje nuk është e orientuar kundër ndonjë shteti, entiteti apo individ. Ajo nuk i cenon të drejtat dhe obligimet që rezultojnë nga marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale të cilat janë në fuqi, të cilat të dyja Palët i kanë nënshkruar me shtete tjera ose organizata ndërkombëtare.

8. Pala e parë do ta zbatojë këtë marrëveshje në pajtim me obligimet e saja të cilat rezultojnë nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi i saj në institucione ose organizata tjera ndërkombëtare, multilaterale ose rajonale si dhe në pajtim me instrumentet tjera ndërkombëtare. Në mënyrë të ngjashme, Pala e dytë do ta zbatojë këtë marrëveshje në pajtim me obligimet e saj të cilat rezultojnë nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi i saj në institucione ose organizata tjera ndërkombëtare, multilaterale ose rajonale si dhe ato në lidhje me Bashkimin Evropian, pas propozimit për anëtarësimin e saj.

9. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje mbesin në fuqi në periudhë të papërcaktuar dhe janë të përvokueshme. Nuk lejohet asnjë ndryshim i dispozitave nga neni 1, paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i kësaj marrëveshjeje.

10. Kjo marrëveshje do të regjistrohet në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, nga momenti i hyrjes në fuqi.

NË DËSHMI TË KËSAJ, Palët nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të angazhuar kompetentë, i kanë nënshkruar tre ekzemplarët e kësaj marrëveshjeje finale, në gjuhën angleze.

Përfaqësues i Palës së Parë

I BËRË në Prespë, më 17 qershor 2018